



Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika b e Ligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për vendosjen e dispozitave për menaxhimin dhe implementimin e ndihmës financiare të Unionit për Republikën e Maqedonisë sipas instrumentit i ndihmës për para-anëtarësim nga fusha e politikave për “Bujqësi dhe Zhvillim rural” (IPARD) nga ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/2016), në bazë të Pjesës II masa Investime në mjete materiale për ekonominë bujqësore pika 11 nga Programi për shfrytëzimin e mjeteve nga Instrumenti i ndihmës së para-anëtarësimit për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD) për periudhën 2014-2020 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 177/2016), dhe në bazë të nenit 6 të Rregullores për mënyrën dhe procedurën për shfrytëzimin e mbështetjes financiare për masat për zhvillim rural të financuar nga Programi IPARD 2014-2020 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2016)

Agjencia për Mbështetje Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural

më 26 dhjetor 2018, shpall

THIRRJE PUBLIKE Nr. 02/2018

për dorëzimin e aplikacioneve për shfrytëzimin e mjeteve nga

Programi IPARD 2014-2020

PJESA I

1. Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural (në tekstin e mëposhtëm: Agjencia) si institucion kompetent dhe një organ kontraktues për zbatimin e Instrumentit për ndihmë para-anëtarësimit për zhvillim rural të BE (IPARD) fton të gjithë personat fizik dhe juridik të interesuar nga Republika e Maqedonisë të dorëzojnë aplikacione për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020 për masën e mëposhtme:

1. Investime në mjete materiale në ekonominë bujqësore

2. Mbështetja financiare për këtë Thirrje publike është e përbërë nga 75% mjete të siguruara nga Instrumenti për ndihmë para-anëtarësimit për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD) sipas Marrëveshjes Financiare 2014-2020 dhe 25% mjete të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

3. Mjete financiare për aplikacion individual jepen si mbështetje financiare e pakthyeshme (grant) në vlerë prej:

- 3.1. 60% e vlerës së totalit të harxhimeve të pranueshme të investimeve për masën Investime në mjete materiale për ekonominë bujqësore. Përqindja rritet në 65% për

investime në ekonomitë bujqësore të propozuara nga bujq të rinj (persona fizik në moshë prej 18 vjet deri në 40 vjet në ditën e dorëzimit të aplikacionit për mbështetje financiare) dhe 70% për investime në ekonomi bujqësore në regjionet malore.

4. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 9 shkurt 2019

5. Mbështetja totale financiare në suaza të kësaj thirrje publike është 11.883.772,00 euro ose 730.792.598,00 denarë.

Marrja e formularëve dhe udhëzimeve:

Formularët e nevojshëm nga "Aplikacioni për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020" si dhe "Udhëzimi për shfrytëzuesit e mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020" për çdo masë veç e veç që përmban të gjitha informatat mbi kriteret, kushtet për pranim të projekteve dhe kushtet e financimit dhe informacione të tjera të nevojshme për përgatitjen e një kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020, Udhëzim për përgatitjen e një Biznes plani/Projekt propozim teknik, Udhëzime për dhënien e dokumentacionit të nevojshëm nga institucionet përkatëse dhe informacione të tjera të dobishme në formë elektronike mund të shkarkohen nga veb adresa e Agjencisë: www.ipardpa.gov.mk.

6. Mënyra e dorëzimit të aplikacionit:

Aplikanti duhet të plotësojë dhe të dorëzojë një Aplikacion për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020 për një masë individuale, Biznes Plan të përgatitur në përputhje me Udhëzimin për përgatitjen e një Biznes plani ose Projekt propozim teknik dhe dokumentacionin shoqërues siç specifikohet në këtë Thirrje Publike.

Aplikacioni i plotësuar për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020 së bashku me Biznes planin/Projekt propozimin teknik dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dorëzohen në një zarf të mbyllur me shënim në pjesën e përparme të zarfit në këndin e majtë të sipërm "MOS E HAP" për Thirrje publike IPARD Nr. 02/2018 dhe shënimin e masës për të cilën dorëzohet aplikacioni. Aplikacioni mund të dorëzohet me postë si dërgesë e rekomanduar ose personalisht në arkivin e Agjencisë.

Shënim: Për shkak të kryerjes së kontrollit në terren nga Agjencia, aplikanti duhet me vete të ketë kopjet nga dokumentacioni i tërësishëm i dorëzuar në Agjenci.

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose kontakt në e-mail adresë: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në faqen e internetit: www.ipardpa.gov.mk.

PJESA II

INVESTIME NË MJETE MATERIALE TË EKONOMIVE BUJQËSORE

1. Mbështetja financiare për masën "Investime në mjete material të ekonomive bujqësore" është destinuar për investime të duhura që kanë të bëjnë me sektorët prioritarë në vijim: prodhimtarinë bimore, prodhimtarinë blegtorale, përpunimin dhe marketingun e drejtpërdrejtë të prodhimit personal të ekonomisë bujqësore, prodhimtarinë e energjisë nga burime të rinovueshme për konsum personal.

2. Lloji i investimit

a. Prodhimtaria bimore: (1) drithëra, (2) kultura industriale (3) perime (duke përfshirë edhe patate), (4) kultura shumëvjeçare (pemishte, duke përfshirë rrush, ullinj, pemë për prodhimin e mjaltit dhe (5) vreshta;

b. Prodhimtaria blegtorale: (1) Gjedh (për prodhimin e qumështit dhe trashje), (2) derra (për shumim dhe trashje), (3) dhen dhe dhi (për prodhimin e qumështit dhe trashje), (4) shpezë (për prodhimin e mishit – zogj për mish, dhe pula që bëjnë vezë);

c. Përpunim dhe marketing i drejtpërdrejtë i prodhimit personal të ekonomisë bujqësore, (Marketingu i drejtpërdrejtë ka të bëjë me aktivitetet e lidhura me produktet bujqësore të prodhuara në ekonominë bujqësore, përgatitje, shitje e drejtpërdrejtë dhe aktivitete tjera të marketingut të ekonomisë bujqësore, duke përfshirë produktet e përpunuara të ekonomisë bujqësore: (1) qumësht dhe produktet e qumështit (2) mish dhe produktet e mishit; (3) pemë dhe perime, duke përfshirë patate, kërpudha dhe kulturat leguminoze (4) drithëra, produkte mulliri dhe produkte të niseshtes, (5) vajra dhe yndyrëra bimore dhe shtazore, (6) shirë rrushi, lëng rrushi, verë dhe uthull.

ç. Prodhimi i energjisë nga burimet e rinovueshme për konsum personal, përmes përpunimit të produkteve bimore dhe shtazore të biomasës primare dhe sekondare (me përjashtim të biomasës të produkteve të peshkut) për prodhimin e biogazit dhe / ose biokarburanteve, duke përdorur energjinë diellore, turbinën e erës, energjinë gjeotermale, etj.

SHËNIM: FURNIZIMI I TRAKTORIT NUK ËSHTË HARXHIM I PRANUESHËM NË KËTË THIRRJE PUBLIKE!

3. Përdorues

Llojet e mëposhtme të përdoruesve mund të aplikojnë dhe të përdorin mbështetje nga kjo masë:

I. Ekonomi bujqësore

II. Kooperativa

- I. Ekonomi bujqësore që janë regjistruar në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore (RVEB) në MBPEU në përputhje me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural.

Ekonomia bujqësore mund të regjistrohet në RVEB si ekonomi bujqësore familjare e përfaqësuar nga një person fizik ose një fermer individual ose si një ekonomi bujqësore e përfaqësuar nga një person juridik.

- Personi fizik është anëtar i ekonomisë bujqësore familjare e cila është e autorizuar nga të gjithë anëtarët e tjerë të ekonomisë bujqësore, për ta përfaqësuar ekonominë bujqësore para autoriteteve kompetente dhe për ta menaxhuar atë. Përfaqësuesi i autorizuar dhe anëtarët e tjerë të ekonomisë bujqësore duhet të jetojnë në të njëjtën adresë që është dhënë si seli e ekonomisë, bujqësore, pavarësisht vendndodhjes së pronës bujqësore (tokë dhe objekte).
- Prodhuesi individual bujqësor është person fizik i cili merret me bujqësi për nevojat e tij personale si pronar i pronës bujqësore ose që ka të drejtën e përdorimit të pronës

bujqësore të marrë nëpërmjet lidhjes së një marrëveshjeje ligjore me pronarin e pronës dhe është i regjistruar në Regjistrin e fermerëve individual të Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujit ose si prodhues individual bujqësor në Fondin e Sigurimit Pensional dhe invalidor. Prodhuesi individual bujqësor regjistrohet si ekonomi bujqësore familjare në RVEB.

- Person juridik që përfaqëson ekonominë bujqësore të regjistruar në Regjistrin Qendror në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare të R.M.

- II. **Kooperativa** që është regjistruar në Regjistrin Qendror sipas Ligjit për Kooperativa, që kryesisht merret me veprimtari bujqësore, përpunim të produkteve bujqësore dhe/ose shërbime që janë të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet bujqësore.

Kooperativa që merret kryesisht me prodhimin bujqësor duhet të regjistrohet në pajtim me Ligjin për Kooperativa Bujqësore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 23/2013, 51/2015, 193/2015 dhe 39/2016) dhe të jetë e regjistruar në Regjistrin e Kooperativave Bujqësore të MBPEU.

4. Kriteret e pranimit

- Të gjithë aplikantët që aplikojnë për investime që lidhen me prodhimin bimor në momentin e aplikimit duhet të demonstrojnë ekzistencën e tokës së punueshme bujqësore të regjistruar në Sistemin për identifikimin e parcelave të tokës (SIPT) me madhësi minimale në varësi të llojit të prodhimit bimor që është lëndë e investimeve siç është paraqitur në tabelën e mëposhtme.
- Të gjithë aplikantët që aplikojnë për investime që lidhen me prodhimin blegtoral duhet të demonstrojnë ekzistencën e një numri minimal të njësive të bagëtisë (NjB) të regjistruara në Regjistrin për identifikimin e kafshëve të udhëhequr nga ana e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinerisë (AUV) para dorëzimit të kërkesës për pagesë me madhësi minimale në varësi të veprimtarisë së prodhimit blegtoral që i nënshtrohet investimit siç është paraqitur në tabelën mëposhtme.
- Aplikantët të cilët me investimin fillojnë të merren me prodhimin blegtoral ose të cilët nuk e përmbushin kapacitetin minimal të NjB mund të aplikojnë dhe të përdorin mbështetje, nëse me realizimin e investimit përmbushin kapacitetin minimal në lidhje me NjB, që duhet të jetë qartë i dhënë në Propozim Projektin Teknik / Planin e Biznesit.

KRITERET PËR KAPACITETET PRODHUESE TË APLIKANTIT

SEKTORI PRIORITAR				Sipërfaqe minimale që përpunohet/kapacitet prodhues i regjistruar në SIPT /AUV
PRODHIMTARIA	Bimë	shumë	vjeçare	Min. 0,3 ha

BIMORE	(kultura) dhe oranzheri	
	Prodhimtari kopshtare në të hapur	Min. 0,5 ha
PRODHIMTARIA BLEGTORALE	Bagëti	5 Njësi të bagëtisë (NjB)*
	Dhen dhe/ose dhi	1,5 Njësi të bagëtisë (NjB)
	derra	8 Njësi të bagëtisë (NjB)
	Shpezë (me përjashtim të rosave, patave, gjeldetit, fazanëve, struçëve, emujve dhe pulave afrikane)	10 Njësi të bagëtisë (NjB)

* Njësitë e bagëtive llogariten sipas Aneksit Nr. 11 të PROGRAMIT IPARD 2014-2020.

Të gjithë aplikantët që planifikojnë investime në mekanizimin bujqësor në momentin e aplikimit duhet të demonstrojnë minimum 1 ha tokë bujqësore përpunohet nën prodhimin bimor të regjistruara në Sistemin e Identifikimit të Parcelës së Tokës (SIPT).

Aplikantët, përveç që duhet të tregojnë kapacitetet e regjistruara të prodhimit në SIPT është e nevojshme të vërtetojnë pronësinë ose të drejtën e përdorimit të tokës duke dorëzuar fletë pronësinë bashkë me kërkesën, si dhe një kontratë për qiramarrje me kohëzgjatje jo më pak se 7 vjet nga data e aplikimit. Kontrata e qiramarrjes, kohëzgjatja dhe sipërfaqja të cilat kanë të bëjnë me kontratën duhet patjetër të jenë të shënuara në fletën e pronësisë.

Përdoruesit janë të detyruar të evidentojnë të gjitha ndryshimet në kapacitetet prodhuese në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore dhe në sistemin për identifikimin e parcelave të tokës dhe/ose Regjistrin për identifikimin e kafshëve sidomos atyre ndryshimeve që janë rezultat i investimit të realizuar para dorëzimit të aplikacionit përfundimtar për pagesë.

Personi përgjegjës në personin juridik ose kooperativën bujqësore/bartësi i ekonomisë bujqësore:

- duhet të dëshmojë se ka kryer së paku arsim të mesëm ose arsim të lartë përmes diplomës/certifikatës ose
- duhet të dëshmojë të paktën 3 vjet përvojë pune në fushën e prodhimit bujqësor, përpunimit ose shërbime që lidhen me bujqësinë (dëshmuar nëpërmjet dëshmisë së përvojës profesionale ose nëpërmjet dëshmisë si shfrytëzues i programeve kombëtare për mbështetje në bujqësi dhe zhvillim rural apo tjera dëshmi me shkrim të pranueshme)

- të paraqesë dëshmi se të paktën njëri nga menaxherët e personit juridik, që w përfaqësojnë person juridik në procedurën para Agjencisë, është në marëdhënie të rregullt pune tek personi juridik, që paraqitet si kërkues i mbështetjes financiare ose është i angazhuar me kontratë me kohëzgjatje jo më pak se kohëzgjatja e kontratës për mbështetje financiare të lidhur me Agjencinë.

5. Vlera e financimit

Vlera minimale e harxhimeve të pranueshme për çdo projekt të veçant është 3,000 euro në kundërvlerë të denarit.

Vlera maksimale e mbështetjes financiare për përdorues nuk mund të tejkalojë 1.500.000 euro në kundërvlerë të denarit për tërë periudhën e zbatimit të Programit IPARD 2014-2020.

Mbështetja totale financiare (75% fonde të BE-së + 25% bashkëfinancim kombëtar) nuk do ta tejkalojë kufirin e sipërm prej 60% të harxhimeve të pranueshme totale të investimeve.

Kjo përqindje e kofinancimit mund të rritet deri më:

- 65% për investimet në ekonomitë bujqësore të propozuara nga fermerët e rinj (personat fizik nga mosha 18 deri 40 vjet në ditën e dorëzimit të aplikacionit për mbështetje financiare);
- 70% për investimet në ekonomitë bujqësore në zonat malore.

Përqindja e kofinancimit do të rritet për 10% për pjesën e investimit që ka të bëjë me:

- Investimet në sistemet e magazinimit dhe menaxhimit të plehut organik (p.sh.: ruajtja, trajtimi, përdorimi i mëtejshëm, etj.);
- Investimet për të përmirësuar efikasitetin e përdorimit të plehrave të azotit (p.s. : përdorimi i reduktuar, pajisjet për përdorim të saktë të plehrave, etj.);
- Investime në objekte/pajisje, qëllimi i të cilave është përmirësimi i efikasitetit energjetik (p.sh. shfrytëzimi i materialit ndërtimor që redukton humbjen e nxehtësisë);
- Investime në objekte/pajisje për prodhimin e bio-energjisë në rastin e përpunimit të produkteve (lëndëve të para) që është përfshirë në Aneksin 1 të Marrëveshjes me BE (përpunimi i biomasës primare dhe sekondare të kafshëve dhe bimëve);
- Investimet në objekte/pajisje për prodhimin e energjisë nga burime të tjera të energjisë që ripërtërihen për plotësimin e nevojave të tyre për energji në ekonominë bujqësore;
- Investime në objekte/pajisje për trajtimin e ujërave të zeza/kanalizimit.

Shënim: Rritja e përqindjes së mbështetjes financiare me 10 pikë përqindje ka të bëjë vetëm me pjesën e investimit për të cilën është bërë rritja e mbështetjes dhe jo për tërë investimin e propozuar.

6. Lista e dokumenteve të nevojshme

Dokumentet e mëposhtme që dorëzohen bashkë me aplikacionin për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi IPARD (2014- 2020) duhet të jetë origjinale ose një kopje e vërtetuar nga noteri, nëse nuk është përcaktuar ndryshe nga vetë dokumenti. Nëse dokumentacioni është në një gjuhë tjetër, i njëjti duhet të shoqërohet me një përkthim në gjuhën maqedonase të vërtetuar nga një përkthyes i autorizuar. Dokumentet që jepen në bazë të regjistrave publik apo një sistem i themeluar të evidencës, nuk duhet të jetë më të

vjetra se tre muaj nga data e thirrjes publike, me përjashtim të dokumenteve që e konfirmojnë përmbushjen e detyrimeve për taksat dhe kontributet e paguara që nuk duhet të jetë më i vjetër se një muaj llogaritur nga data e shpalljes së thirrjes publike.

1. APLIKACION PËR MASËN INVESTIME NË MJETE MATERIALE TË EKONOMIVE BUJQËSORE

2. LETËR NJOFTIM OSE PASAPORTË VALIDE (KOPJE)

3. LLOGARI TË TRANSAKSIONIT TË APLIKANTIT (KOPJE)

4. DËSHMI PËR ARSIM TË KRYER (SË PAKU SHKOLLË TË MESME) TË APLIKANTIT- PERSON FIZIK APO PERSON PËRGJEGJËS I PERSONIT JURIDIK APO KOOPERATIVËS BUJQËSORE, OSE DËSHMI PËR NDJEKJEN E TRAJNIMIT TË RËNDËSISHËM PËR INVESTIMIN OSE DEKLARATË E NËNSHKRUAR SE APLIKANTI PRANON TË MARRË PJESË NË TRAJNIM PROFESIONAL TË RËNDËSISHËM PËR INVESTIMIN

5. DEKLARATË E APLIKANTIT SE NË FUND TË INVESTIMIT DO TË JETË I REGJISTRUAR PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHITESË (PËR PËRPUNIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE) TË EKONOMISË BUJQËSORE (Ky dokument është i detyrueshëm në rastet kur aplikanti është një ekonomi bujqësore që propozon investime të reja gjegjësisht aplikanti nuk është i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë shtesë në momentin e dorëzimit të kërkesës).

6. DEKLARATË E APLIKANTIT SE NË FUND TË INVESTIMIT DO TË REGJISTROHET NË REGJISTRIN E EKONOMIVE BUJQËSORE (Ky dokument dorëzohet në rast se aplikanti propozon investime të reja në prodhimin blegtoral)

7. DEKLARATË E APLIKANTIT SE ËSHTË I NJOFTUAR ME KUSHTET E PËRCAKTUARA NË LISTËN E KUSHTEVE TË VEÇANTA MINIMALE PËR PRAKTIKË MË TË MIRË BUJQËSORE DHE MBROJTJE TË MJEDISIT JETËSOR TË SHPALLURA NË "GAZETËN ZYRTARE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NR. 178/2015" DHE TË NJËJTAT DO T'I RESPEKTOJË DHE DHE ZBATOJË NË TËRË EKONOMINË BUJQËSORE PARA DORËZIMIT TË KËRKESËS PËR PAGESË.

8. LIBËR AKSIONAR DHE LETËR E INTERESIT (Këto dokumente janë të nevojshme në rast se aplikanti është shoqatë aksionare dhe në rast se nuk ka të dhëna në faqen e internetit të kompanisë në veb faqen e Depozituesit qendror të letrave me vlerë të Republikës së Maqedonisë).

9. DËSHMI SE TË PAKTËN NJË PERSON PËRGJEGJËS ËSHTË NË MARËDHËNIE TË RREGULLT PUNE ME SUBJEKTIN JURIDIK OSE DËSHMI SE TË PAKTËN NJË PERSON PËRGJEGJËS ËSHTË ANGAZHUAR ME KONTRATË, OSE DËSHMI SE TË PAKTËN NJË PERSONI PËRGJEGJËS ËSHTË PËRKOHËSISHT I PUNËSUAR TE SUBJEKTI JURIDIK (çertifikata është e detyrueshme në rastet kur aplikanti ka kompani të regjistruar, gjegjësisht në rast të investimit të ri, një nga këto dokumente duhet të dorëzohet deri në fund të investimit).

10. DËSHMI PËR PAGESË TË DETYRIMEVE PËR TAKSAT, SIGURIMIN PENSIONAL DHE INVALIDOR DHE SIGURIMIN SHËNDETËSOR.

11. DËSHMI QË APLIKANTI NUK ËSHTË NË PROCEDURË FALIMENTIMI DHE LIKUIDIMI (Ky dokument është i domosdoshëm vetëm për aplikantët që janë persona juridik).

12. DËSHMI SE KUNDËR APLIKANTIT NUK ËSHTË SHQIPTUAR SANKSION I SHKELJES NDALESË PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË OSE PROFESIONIT (Ky dokument është i domosdoshëm vetëm për aplikantët që janë persona juridik).

13. VENDIM PËR ELABORAT TË MIRATUAR PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR, OSE VENDIM PËR ELABORAT TË MIRATUAR PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR ME PLAN AKSIONAR, OSE A OSE B EKO LEJE TË INTEGRUAR OSE APLIKACION TË MIRATUAR PËR DHËNIEN E A OSE B EKO LEJES TË INTEGRUAR OSE APLIKACION PËR DHËNIEN E VENDIMIT PËR ELABORAT TË MIRATUAR PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR OSE VËRTETIM SE EKONOMIA BUJQËSORE (APLIKANTI) NUK ËSHTË I OBLIGUAR TË PËRGATISË ELABORAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT JETËSOR (dokumenti u referohet aplikantëve të cilët kanë regjistruar ose propozojnë investime për prodhimin e qumështit, mishit vezëve, aktivitete pas vjeljes dhe përpunimin e produkteve bujqësore të ekonomisë bujqësore.)

14. DOKUMENTE PËR PRONËSI DHE/OSE TË DREJTË PËR SHFRYTËZIMIN E TOKËS/OBJEKTIT QË JANË OBJEKT I INVESTIMIT

- 1. FLETË PRONËSIE PËR OBJEKTIN DHE/OSE TOKËN**
- 2. KONTRATË PËR QIRAMARRJE PËR OBJEKTIN DHE/OSE TOKËN**
- 3. KONTRATË PËR KONCESION TË TOKËS**

Marrëveshja është e vlefshme së paku 7 vjet llogaritur nga dita dorëzimit të aplikacionit për mbështetje financiare në rast të blerjes së mekanizimit/pajisjeve;

15. DËSHMI PËR PAGESË TË RREGULLT TË DETYRIMEVE NË BAZË TË MARRËVESHJES PËR KREDI (Dokumenti dorëzohet vetëm atëherë kur Banka ka vendosur garanci në pronën që është objekt i investimit).

DOKUMENTE PËR PUNËT E NDËRTIMIT

(DOKUMENTET E MËPOSHTME DUHET TË MERREN NË PËRPTHJE ME DISPOZITAT E LIGJIT PËR NDËRTIM)

16. LEJE NDËRTIMI OSE DEKLARATË NGA APLIKANTI SE LEJA RELEVANTE DO TË DORËZOHET DERI NË LIDHJEN E MARRËVESHJES (Deklarata dorëzohet në rast se Aplikanti nuk ka mundësi ta marrë lejen deri në datën e dorëzimit të aplikacionit për shfrytëzimin e mjeteve).

OSE DEKLARATË NGA INSTITUCIONI KOMPETENT QË PËR INVESTIMIN E PROPOZUAR LEJA NUK ËSHTË E NEVOJSHME.

17. KOPJE TË VIZATIMEVE TEKNIKE THEMELORE DHE LLOGARITJE REFERUESE E RISHIKUAR NGA DOKUMENTACIONI TEKNIK (OSE FORMË ELEKTRONIKE - CD) (dokumentacioni i projektit që dorëzohet në Agjencinë për mbështetje financiare në zhvillimin bujqësor dhe rural duhet të përputhet plotësisht me dokumentacionin e projektit (numri teknik) që dorëzohet/do të dorëzohet deri te organi kompetent si pjesë e kërkesës për marrjen e lejes për ndërtim).

(Dokumenti duhet të vërtetohet nga persona të autorizuar për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe auditorët)

18. SITUATA/GJENDJA E PËRKOHSHME PËR TË GJITHA NDËRTIMET E PËRFUNDUARA (Situata/gjendja e përkohëshme dorëzohet në rast kur aplikanti ka ndërtuar një pjesë të objektit që është objekt i investimit, gjegjësisht punët e kryera të ndërtimit duhet të jenë në përputhje me dokumentacionin teknik të fundit të aprovuar).

19. DOKUMENTE PËR VËRTETIMIN E KAPACITETIT /QËNDRUESHMËRISË EKONOMIKE

1. PLANI I BIZNESIT

(Plani i biznesit është një dokument i domosdoshëm nëse vlera e përgjithshme e investimit të planifikuar është më e madhe se 50,000 euro në kundërvlerë të denarit, pa TVSH).

2. PROJEKT PROPOZIMI TEKNIK

(Projekti propozimi teknik është një dokument i domosdoshëm nëse vlera e përgjithshme e investimit të planifikuar është më pak se 50,000 euro në kundërvlerë të denarit, pa TVSH).

20. OFERTA PËR PUNËT / PAJISJET E NDËRTIMIT

1. OFERTË NGA FURNIZUESI PËR ÇDO ARTIKULL / GRUP ARTIKUJSH, NË VLERË JO MË PAK SE 10.000 EURO NË KUNDËRVLERË TË DENARIT

2. TRI OFERTA NGA FURNIZUES TË NDRYSHËM, PËR ARTIKULL / GRUP ARTIKUJSH NË VLERË JO MË TË MADHE SE 10.000 EURO NË KUNDËRVLERË TË DENARIT

3. DEKLARATË NGA FURNIZUESI/T PËR VENDIN E ORIGJINËS

Deklarata është një dokument i domosdoshëm nëse oferta është me vlerë mbi 100.000 euro.

(Deklarata është një dokument i domosdoshëm në rast se në ofertë nuk ka të dhëna për vendin e origjinës dhe prodhuesin e makinerisë / pajisjeve).

21. DËSHMI PËR STRUKTURËN PRONËSORE PËR TË GJITHË FURNIZUESIT E HUAJ

22. LIBËR AKSIONAR NË FORMË ELEKTRONIKE - CD / LETËR DHE / OSE LETËR INTERESI (Dokumentet e mësipërme janë të domosdoshme në rast kur furnizuesi është një shoqëri aksionare).

23. DEKLARATË NGA APLIKANTI PËR SHPJEGIMIN E ARSYEVE PËR ZGJEDHJEN E OFERTËS KONKRETE

(Dokumenti është i domosdoshëm kur prokurimi është me vlerë më të madhe se 10.000 euro në kundërvlerë të denarit për artikull / grup artikujsh, nëse mallrat / shërbimet e zgjedhura nuk kanë vlerën më të ulët).

24. OFERTË / FATURË / KONTRATË PËR HARXHIME TË PËRGJITHSHME (për furnizime me vlerë mbi 10.000 euro në kundërvlerë të denarit të nevojshme për të dorëzuar 3 oferta për çdo artikull)

(HARXHIMET E PËRGJITHSHME PRANOHEN NËSE TË NJËJTAT JANË BËRË PAS 01.01.2014)

Agjencia ruan të drejtën të kërkojë dokumentacion shtesë për të dëshmuar përmbushjen e kritereve të Programit IPARD 2014-2020 për shfrytëzimin e mbështetjes financiare. Gjithashtu, Agjencia ka të drejtë të kërkojë dokumente shtesë për Aplikantin nga Institucionet e tjera që vërtetojnë përmbushjen e kritereve përkatëse të Programit.

PJESA V

PROCEDURA PARA AGJENCISË

Procedura e Agjencisë nga pranimi i Aplikacioneve deri në lidhjen e Kontratës për shfrytëzimin e mjeteve përbëhet nga:

1. Kontrollimi i kompletimit të dokumenteve të dorëzuara në përputhje me dokumentet e kërkuara për masat dhe llojet e investimeve, si më poshtë:

- A janë dhënë dokumente nga institucionet e duhura;
- A posedojnë dokumentet të gjitha elementet me të cilat vërtetohet se janë të besueshme (vulë, nënshkrim të personit përgjegjës, datë, etj)
- Nëse dokumentet janë të vlefshme për periudhën e specifikuar në *Listën e Dokumenteve*;

Aplikanti duhet të bëjë plotësim të aplikacioneve të pakompletuara për shfrytëzimin e mjeteve në bazë të njoftimit me shkrim të marrë nga Agjencia. Afati për plotësimin e aplikacioneve të pakompletuara është 8 ditë nga data e pranimit të njoftimit.

2. Kontrolli i përshtatshmërisë së aplikacionit për shfrytëzimin e mjeteve bëhet me qëllim që të vërtetohet:

- Nëse dokumentet e dorëzuara dëshmojnë plotësimin e kritereve dhe kushteve për pranueshmërinë e aktiviteteve të propozuara të investimit;
- Nëse investimi i propozuar është ekonomikisht dhe financiarisht i realizueshëm dhe i qëndrueshëm, gjë që mund të kontrollohet duke analizuar parametrat e përmbajtura në biznes planin e bashkangjitur;
- Nëse investimi i propozuar për të cilin kërkohet mbështetje financiare nuk është financuar nga burime të tjera publike (Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe donatorët ndërkombëtarë);
- A janë çmimet e aktiviteteve të propozuara të investimit në suaza të çmimeve të tregut duke analizuar çmimet referente për aktivitetet përkatëse.

Ndihmë mund t'u jepet shfrytëzuesve, projektet investuese të cilëve mundësojnë qëndrueshmëri financiare / ekonomike. Qëndrueshmëria ekonomike dhe financiare do të vlerësohet në bazë të një biznes plani. Aplikanti me biznes planin duhet ta tregojë mundësinë e vazhdimësisë së punës për të paktën pesë vjet nga realizimi i investimit. Projekti investues do të vlerësohet në bazë të treguesve të mëposhtëm ekonomik:

- Normë e brendshme e modifikuar e rentabilitetit që duhet të jetë më e madhe se 0,
- Neto vlere aktuale që duhet të jetë më e madhe se 0, dhe
- Periudha e kthimit të investimit që duhet të jetë më pak se 10 vjet

Në rastin e projekteve të propozuara që arrijnë vlerë më pak se 50,000 euro, qëndrueshmëria ekonomike demonstronhet përmes Projekt Propozimit Teknik që do të përmbajë tregues financiar në kuptimin e gjenerimit të të ardhurave të mjaftueshme që do të arrijnë harxhimet operative të ekonomisë bujqësore.

Me qëllim të përcaktimit të origjinalitetit të parametrave teknik, të të dhënave ekonomike dhe financiare, Agjencia ka të drejtë të kërkojë dokumente dhe informata shtesë si bazë për marrjen e vendimit.

Verifikimi i besueshmërisë të të dhënave të përmbajtura në Aplikacionin për shfrytëzimin e mjeteve kryhet nga persona të autorizuar të Agjencisë me kontroll në vendngjarje.

Rangimi bëhet për të gjitha aplikacionet e plota dhe të përshtatshme për shfrytëzimin e mjeteve sipas tabelave të bashkangjitura të rangimit sipas masave të caktuara.

Mbështetja financiare do të miratohet për të gjitha aplikacionet e plota dhe të përshtatshme për shfrytëzimin e mjeteve në suaza të mjeteve në dispozicion në bazë të kontrolleve të kryera administrative dhe kontrollit në vendngjarje.

Aplikacionet jo të plota, të papërshtatshme si dhe aplikacionet për shfrytëzimin e mjeteve që kanë një numër më të vogël pikësh në raport me mjetet në dispozicion për një masë, do të refuzohen me Vendim.

Me aplikantin, të cilit i miratohet aplikacioni për shfrytëzimin e mjeteve, nënshkruhet një Kontratë brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të Vendimit për miratimin e mjeteve nga Programi IPARD 2014-2020.

Aplikantët nuk mund të fillojnë me zbatimin e investimit para nënshkrimit të Marrëveshjes për ndarjen e mjeteve me Agjencinë, me përjashtim të aktiviteteve të lidhura me HARXHIMET e përgjithshme (përgatitjen e biznes planit, projekt propozimit teknik, studimin e fizibilitetit, arkitektë, dokumentacionin e projektit, etj).

Pas përfundimit të investimit, Aplikanti është i detyruar të paraqesë në Agjenci një aplikacion për pagesë brenda afatit të caktuar në Kontratë për shfrytëzimin e mjeteve.

Aplikanti i cili do të nënshkruajë kontratë me Agjencinë është i obliguar, investimin që është subjekt i marrëveshjes, mos ta tjetërsojë, ta jap me qira ose hua, mos ta ndryshojë qëllimin dhe vendndodhjen e të njëjtit për tërë kohëzgjatjen e Marrëveshjes, gjegjësisht 5 vjet nga pagesa e fundit e mjeteve financiare.

Kontroll në vendngjarje dhe zbatimi i mbikëqyrjes së kontratës kryhet nga persona të autorizuar nga institucionet relevante nga Republika e Maqedonisë dhe Bashkimi Evropian.